- (c) Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet shumës në fjalë dhe shumës në shifra, mbizotëron shuma në fjalë. Bën përjashtim nga ky rregull situata kur, shuma në fjalë ka mospërputhje me shumën në shifra, ndërkohë që kjo e fundit nuk ka gabime aritmetike në përllogaritjen e zërave të ofertës.

Në çdo rast, Ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur:

- shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;
- shuma absolute e të gjitha korrigjimeve është më pak se 2%, por nuk pranohet korrigjimi nga ofertuesi.

2. Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përllogaritur.

- Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet ti kërkojë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe të vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin, në përputhje me dispozitat e këtij neni.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementët specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

$$MO = O1 + O2 + O3 + \dots On / N$$

$$PR = 85 \% Mo$$

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

27. Njoftimi i Fituesit

Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

28. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/Kontratës

1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.

2 Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
- b) garanci bankare
- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

29. Procedura e ankesës

1 Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin dhe /ose përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë për t'u ftuar për të paraqitur oferta, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.

2.Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, në Sistemin e Ankesave Elektronike.

Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik

3 Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

30 Anulimi i procedurës

1 Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.

2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:

- a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
- b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;

c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;

d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;

e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021 të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të pikës 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

4. Nëse Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në sistemin e prokurimit elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

- Shtojca 1. Formulari i Kërkesës për Pjesëmarrje
- Shtojca 2. Ftesa për Ofertë për Kandidatët e përzgjedhur, faza II
- Shtojca 3. Formulari i Ofertës Ekonomike
- Shtojca 4. Lista e Çmimeve sipas Elementëve Përbërës të Shërbimit
- Shtojca 5. Formulari i Sigurimit të Ofertës
- Shtojca 6. Lista e Informacionit Konfidencial
- Shtojcë 7. Deklaratë mbi disponueshmërinë e Anëtarit të Stafit
- Shtojca 8. Formulari i Specifikimeve Teknike
- Shtojca 9. Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit
- Shtojca 10. Formulari i Termave të Referencës
- Shtojca 11. Formulari i Kritereve Përzgjedhjes së Ofertuesve
- Shtojca 12. Formulari i Përmbledhës i Vetdeklarimit
- Shtojca 13. Formulari i Njoftimit të skualifikimit
- Shtojca 14. Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit.
- Shtojca 15. Formulari i Njoftimit të Fituesit në përfundim të afateve të ankimit
- Shtojca 16. Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit.
- Shtojca 17. Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër në përfundim të afateve të ankimit.
- Shtojca 18: Formulari i Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit.

Shtojca 1

(Shtojca për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik)

FORMULARI I KËRKESËS PËR PJESEMARRJE

Emri i **Operatorit Ekonomik**_____

Drejtuar: *[Emri dhe adresa e autoritetit /entit kontraktor]*

* * *

Procedura e prokurimit: *[lloji i procedurës]*

Numri i referencës së procedurës / referenca e Lotit

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Botimi (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data]

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, në, të nënshkruarit paraqesim shprehjen tonë të interesit për të marrë pjesë në këtë procedurë.

Emri i Përfaqësuesit të Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 2

*(Shtojcë për tu plotësuar nga autoriteti /enti kontraktor vetëm për operatorët ekonomikë të kualifikuar/
përzgjedhur bazuar në kërkesën për pjesëmarrje)*

FORMULAR I FTESËS PËR OFERTË

[Datë]

Drejtuar: *[Emri dhe adresa e operatorit ekonomik të kualifikuar /përzgjedhur]*

Procedura e prokurimit _____/

Numri i procedurës / referenca e Lotit _____

Në referencë të procedurës së lartpërmendur ju bëjmë me dije se [emri dhe adresa e kandidatit të përzgjedhur], pas vlerësimit të dokumentacionit të paraqitur në fazën e parë, Ju jeni kualifikuar për fazën ofertuese të kësaj procedure prokurimi.

Për këtë arsye, ju kërkojmë të paraqisni pranë [këtij autoriteti/enti kontraktor]

Emri _____

Adresa _____

Ofertën tuaj, duke marrë në konsideratë si më poshtë:

Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertës është:

Data (d/m/v)

Ora: _____

Adresa _____

Kur oferta kërkohet të paraqitet me mjete elektronike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin ofertën në formë elektronike në ueb-faqen zyrtare të APP, www.app.gov.al.

Informacioni mbi ofertat e paraqitura me mjete elektronike i transmetohet të gjithë atyre Operatorëve Ekonomikë që kanë dorëzuar oferta, në bazë të kërkesës së tyre.

Gjuha (ët) e hartimit të ofertës është:

Shqip ☐ Anglisht ☐

Tjetër _____

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit janë si më poshtë:

A) ⁴oferta ekonomike më e favorshme bazuar në kosto ☐

Sipas rëndësisë:

Çmimi ☐ pikët ☐

_____ ☐ pikët ☐

_____ ☐ pikët ☐

_____ ☐ pikët ☐

Autoriteti/enti kontraktor duhet të specifikojë pikët për çdo kriter vlerësimi të përcaktuar.

OSE

B) oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmim ☐

Në rastin e Marrëveshjes Kuadër, kur do të përdoret kriteri i vlerësimit të çmimit për njësi, për qëllime krahasimi, vlerësimi i ofertave do të kryhet në bazën e shumës së çmimeve për njësi (Kjo metodë e vlerësimit nuk do të përdoret nga autoritetet/entet kontraktore në rastet kur sasi të jenë të vlerësueshme në bazë vjetore sipas përvojës së mëparshme dhe kur Marrëveshja Kuadër është përdorur për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve të vazhdueshme. Në rast të tillë çmimi më i ulët do të vlerësohet me vlerën totale më të ulët ofruar).

Mbetemi në pritje të marrjes së ofertës suaj.

[Drejtuesi i autoritetit /entit kontraktor]

⁴ Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehesh në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë. Në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme, kriter për shpalljen e ofertës fituese do të jetë “oferta ekonomike më e favorshme, bazuar në kosto”, ku çmimi do të ketë 20 pikë dhe propozimi teknik 80 pikë.

Shtojca 3

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik i ftuar për të paraqitur ofertën)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi -të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e kontratës;
 - 3. Kriteret e përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafiku i ekzekutimit;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

- e) Çmimi total i Ofertës sonë, pa TVSH, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Data _____	

Shtojca 4.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** _____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementët përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

1	2	3	4	5	
Nr	Përshkrimi i elementëve përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					

Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbyshjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentet e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentet e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 6

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 7

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARAT⁷Ë

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt _____, është i pamiratur dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁷ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme

Shtojca 8.

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor*]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) *Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;*
- b) *Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit*
- c) *Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.*

Objektivi i Prokurimit

Objektivi i kësaj procedure është të aplikohet zbatimi I ligjit të prokurimit publik me qëllim ofrimin e shërbimit të lavanderisë për nevojat e S.U.O.GJ. "Mbreterësia Geraldinë" Tiranë.

- **Larjes, dezinfektimit, tharjes dhe hekurosjes** së rrobave spitalore dhe tekstileve të tjera të institucionit;
- **Shërbimeve të hotelierisë**, që përfshijnë pastrimin, mirëmbajtjen dhe ndihmën në ambientet e përbashkëta spitalore, sipas standardeve të higjienës dhe sigurisë për institucionet shëndetësore.

Rëndësia e Shërbimit për Institucionin

Materniteti është një institucion shëndetësor që ofron kujdes të vazhdueshëm ndaj grave shtatzëna, lehonave apo të porsalindurve. Roli i shërbimit të lavanderisë dhe hotelierisë është thelbësor për:

- Garantimin e standardit të higjienës në të gjitha repartet dhe dhomat e pacientëve;
- Parandalimin e infeksioneve dhe përhapjes së mikroorganizmave patogjenë;
- Sigurimin e një mjedisi të pastër dhe të sigurt për pacientët dhe stafin mjekësor;
- Mbarëvajtjen e përditshme të veprimtarisë spitalore, duke kontribuar drejtpërdrejtë në cilësinë e shërbimeve shëndetësore që ofrojmë.
- Ofrimi i këtyre shërbimeve nga një subjekt i specializuar është më efikas;
- Këto shërbime sigurojnë cilësi më të lartë, pajisje profesionale dhe staf të trajnuar;
- Garantimi i higjienës së tekstileve dhe ambientit është kritik për sigurinë klinike, sidomos në sektorin e neonatologjisë, obstetrikës, gjinekologjisë e çdo reparti tjetër.

Këto shërbime janë të një rëndësie strategjike për institucionin, pasi ndikojnë drejtpërdrejtë në cilësinë e kujdesit shëndetësor, ruajtjen e higjienës dhe mbrojtjen e shëndetit publik brenda ambienteve spitalore.

Përmes kësaj procedure synohet të sigurohet një operator ekonomik i specializuar, i cili të ofrojë shërbime lavanderie dhe hotelerie në përputhje me standardet më të larta të higjienës dhe sigurisë në institucionet shëndetësore.

Për më tepër, kjo është një masë e nevojshme për të garantuar ofrimin e shërbimeve 24/7, pa ndërprerje, sipas kërkesave specifike të repartit të obstetrikës, gjinekologjisë, neonatologjisë, etj., ku pastërtia dhe dezinfektimi janë absolutisht kritike për mbrojtjen e nënave dhe të porsalindurve.

Bazuar në sa më sipër, procedura konsiderohet urgjente dhe e domosdoshme për të siguruar vijueshmërinë dhe cilësinë e shërbimeve në S.U.O.GJ. “Mbretëresha Geraldinë”.

Shërbimi i lavanderisë do të jetë sipas nevojave të AK-së, ndërsa realizimi do të jetë deri në ditën e fundit të Marrëveshjes Kuadër në përputhje me DST.

Referuar të dhënave që disponohen shërbimi kryhet në bazë të kërkesave ditore, sipas nevojave të pacientëve dhe personelit të S.U.O.GJ. “Mbretëresha Geraldinë”.

SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shërbimi që kërkohet të kryhet nga operatori ekonomik që do të kontraktohet sipas grafikeve të përcaktuar nga AK, rregulloreve dhe protokolleve të higjienës dhe manualeve të kujdesit spitalor.

Operatori ekonomik që do të kontraktohet, duhet të ofrojë një shërbim i cili do të përfshijë:

- Grumbullimin e materialit të butë të papastër në të gjitha pavionet e SUOGJ-së, sipas grafikëve të përcaktuar, rregullave dhe protokolleve të higjienës dhe manualeve të kujdesit spitalor.
- Larja dhe dezinfektimi në repartin e lavanderisë do të bëhet në mënyrë të përqëndruar, duke respektuar të gjitha procedurat dhe protokollet e higjienës, nga marrja në dorëzim e materialit të butë të papastër të ndarë sipas nëndarjeve dhe zonave të rrezikshmërisë (thasët me ngjyrë), tek dorëzimi i materialit të butë, të larë, të hekurosuar dhe të paketuar sipas këtyre protokolleve, deri në shtrimin e shtratit të pacientit sipas protokolleve infermiore. Pjesë e këtij procesi është edhe siguri i pastrimit të plotë kimik – mekanik, në temperaturat e duhura.
- Hekurosjen dhe Paketimin e materialit të butë.
- Shpërndarjen e materialit të butë në të gjithë shërbimet e SUOGJ-së, sipas grafikëve të përcaktuar.
- Shtrimin e shtratit të pacientit.

- Sigurimin e materialit të butë për shtratin e pacientit, personelin shëndetësor si dhe për sallat operatore sipas specifikimeve përkatëse.
- Ripërteritjen e materialit të butë në bazë të normativave dhe afateve përkatëse.
- Shërbimi do të ofrohet 24 (njëzetë e katër) orë, gjatë 7 (shtatë) diteve të javës, operatori ekonomik duhet të sigurojë edhe materialin e butë për mbulimin e nevojave në pavion dhe ndërrimin/shtrimin e shtratit të pacientit gjatë fundjavës dhe ditëve festive, si dhe lënien e bazës materiale rezervë për nevojat e shërbimit gjatë shtrimeve të reja natën dhe urgjencave por edhe sipas grafikut të përcaktuar për ndryshimin periodik të materialit të butë në shërbimet përkatëse dhe sipas kërkesës së Kryeinfermierit të pavionit në rast të ndryshimit të materialit të butë kur bëhet i domosdoshëm për pacientë të veçantë.

SASIA E MATERIALEVE TË BUTA PËR LARJE:

Materiali i butë që do të lahet nga operatori ekonomik privat, grupohet në 3 (tre) kategori:

- 1. Material i butë i pacientëve**
- 2. Material i butë i personelit**
- 3. Material i butë për sallat e operacionit:**

1. Material i butë për pacientët:

- Çarcafë shtrati (i poshtëm, i sipërm/zarf)
- Këllëf jastëku
- Jastëk
- Bizhame pacienti
- Robdishan pacienti
- Jorgan
- Këllëf dysheku
- Pelena fëmijësh
- Batanije fëmijësh
- Tranversa
- Pandofla

2. Material i butë për sallat e operacionit:

- Tranversa
- Garza
- Kostume ekipi salle blu – jo sterile
- Peshqirë
- Pandofla kirurgjie

3. Material i butë për personeli shëndetësor:

- Përparëse për mjekë (të bardha)
- Kostumet e Personelit Mjekësor (infirmier/ ndihmës)
- Peshqirë për mjekë/infirmier/personel ndihmës
- Kostume të stafit

NEVOJAT DHE SPECIFIKIMET:

Tabela 1:

Nr.	Emertimi	Numri total
1	Mjeke	62
2	Infermiere	173
3	Sanitare	72
4	Farmaciste	4
5	Laborant	1
6	Teknik imazherie	2
7	Koordinator me pacientin (Receptionist)	25
8	Magaziniere	1
9	Staf mbështetës	7
		347

Nr.total i shtretërve është 217 sipas kontratës së mëparshme.

Ndërrimi i shtratit të pacientit do të bëhet çdo tre ditë ose dy herë në javë, si dhe në çdo rast që kërkohet nga kryeinfirmieri i pavionit/shërbimit, si pasojë e shtrimit të pacientëve të rinj (me hapjen e kartelës klinike), ose në rastet kur ndryshimi i shtratit bëhet i domosdoshëm për të ruajtur dhe mbrojtur shëndetin e pacientit.

Tabela 2:

Nr.	Shërbimi	Shpeshtësia e Ndërrimit të Çarçafëve
1	OBSTETRIK 1	1 herë në 3 ditë
2	OBSTETRIK 2	1 herë në 3 ditë
3	OBSTETRIK 3	1 herë në 3 ditë

4	SALLE OPERACIONI OBSTETRIKE	1 herë në 3 ditë & para-operacionit dhe pas ditës së dytë të operimit
5	PATOLOGJI BARRE	1 herë në 3 ditë
6	GJINEKOLOGJI KATI II	1 herë në 3 ditë
7	GJINEKOLOGJI KATI III + ABORTAR	1 herë në 3 ditë
8	SALLE OPERACIONI GJINEKOLOGJI	1 herë në 3 ditë & para-operacionit dhe pas ditës së dytë të operimit
9	REANIMACIONI I GRAVE	1 herë në 3 ditë
10	REANIMACIONI I BEBEVE	1 herë në 3 ditë
11	QENDRA E GRUAS	1 herë në 3 ditë
12	DHOMAT E MJEKËVE	1 herë në ditë
13	DHOMAT E STAFIT MBËSHETËS (shofer, kaldaist, oksigjenist)	1 herë në ditë
14	Onkologjia	1 herë në 3 ditë
15	Fekondimi Invitro	1 herë në 3 ditë

*dhe sa herë të jetë e nevojshme me kërkesë të kryeinfermierit të pavionit

Tabela 2/1 Tabelë informuese për peshën dhe frekuencën e pritshme të larjeve të materialeve.

1	Çarçafë shtrati i poshtëm	0.73-0.82	Sipas tabelës 2 sepse çarçafët kanë peshën me të madhe të shërbimit
2	Çarçafë shtrati i sipërm	0.73-0.82	
3	Çarçafë shtrati zarf	1.13-1.27	
4	Jorgan me vatine	2.1	Sa herë të jetë e nevojshme
5	Këllëf dysheku (Kundra Ujit)	0.5	Në çdo shtrim të ri
6	Jastëk	0.88	Sa herë të jetë e nevojshme
7	Këllëf jastëku	0.17-0.19	Në çdo shtrim të ri
8	Rrobdishan pacienti (Për të sëmurët që operohen)	0.27	Në çdo shtrim të ri
9	Përparëse mjeku (të bardha)	0.36	2 herë në javë & sa herë të jetë e nevojshme (Jo i gjithë personeli mjek preferon ta lajë përparësen në lavanderi)

10	Kostumet e Personelit Mjekësor (mjek/infermier/ndihmës)	0.55	2 herë në javë & sa herë të jetë e nevojshme (Jo i gjithë personeli mjek dhe infermier preferon të lajë kostumet në lavanderi)
11	Triko Mjeku dhe Infermieri	0.4	2 herë në javë & sa herë të jetë e nevojshme (Jo i gjithë personeli infermier preferon ta lajë trikon në lavanderi)
12	Pandofla	0.76 (minimumi, pesha varion në varësi të numrit)	1 herë në javë (për ekipin e Sallës së Operacionit) & sa herë të jetë e nevojshme
13	Peshqirë	0.2	Sa herë të jetë e nevojshme
14	Këmisha grashë	0.3	Sa herë të jetë e nevojshme
15	Pelena	0.16	Sa herë të jetë e nevojshme
16	Batanije femijesh	0.63	Sa herë të jetë e nevojshme
17	Traversa	0.11	Sa herë të jetë e nevojshme
18	Garza	0.03	Sa herë të jetë e nevojshme

***dhe sa herë të jetë e nevojshme me kërkesë të kryeinfermierit të pavionit**

Shënim: Për artikujt 1,2,3,7 pesha është përcaktuar duke patur parasysh specifikimet teknike: 160 – 180 gr/m². Për artikujt e tjerë është kërkuar minimumi i peshës pasi këto mund të vajojnë sipas prodhuesve të ndryshëm dhe nuk mund të kufizohen.

Tabela 3

Sasia e materialit të butë të pacientit që duhet ripërtërirë.

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia e blerjeve ne vit	Jetegjatesia	Komentet
1	Çarçaf shtrati i poshtem	Cope	146	4 muaj	Për të gjithë shtretërit
2	Çarçaf shtrati i sipërm/zarf	Cope	140	4 muaj	Për të sipërm: Për çdo Shtrat. 16 Shtator -14 Maj (periudha vjeshtë – dimër dhe kur e kërkon pacienti për efekt të temperaturës) Për zarf: Për çdo Shtrat. 15 Maj deri në 15 Shtator (periudha pranverë – verë & kur e kërkon pacienti për efekt të temperaturës)
3	Kellef jasteku	Cope	145	1 vit	Për çdo Shtrat

4	Jastek	Cope	145	2 vjet	Për çdo Shtrat
5	Kemisha grash	Cope	132	1 vit	Sa herë të jetë e nevojshme
6	Robdishan pacienti	Cope	124	1 vit	Për të gjithë kirurgji
7	Tranversa	Cope	200	1 vit	Sa herë të jetë e nevojshme
8	Peshqire	Cope	158	1 vit	2 peshqir per person
9	Garza	Cope	200	1 vit	Sa herë të jetë e nevojshme
10	Jorgan	Cope	140	2 vjet	16 shtator – 14 maj
11	Kellef dysheku	cope	124	1 vit	Për çdo Shtrat
12	Pelena	Cope	300	4 muaj	Sa herë të jetë e nevojshme
13	Bataniye femijesh	Cope	73	2 vjet	Për çdo Shtrat
14	Pandofla	Cope	347	1 vit	Sipas numerit te personelit mjeksor/infermjeror /sanitar
15	Kostume te ekipit te salles	Pale	30	1 vit	Sipas shpeshtesise se nderimit dhe operacioneve.
16	Perparese mjeku	Cope	235	1 vit	2 cope per person
17	Kostume infermieri / personel ndihmes / sanitare (bluza kemisha + pantallona unisex)	Cope	634	1 vit	2 cope per person
18	Dyshek	Cope	217	3 vjet	Për çdo Shtrat
19	Kostume kordinator	Cope	25	1 vit	2 cope per person

***Sasia e parashikuar është dy uniforma për personelin (mjek, ekipi i sallës, infermier, farmacist, koordinator me pacientin), pasi në momentin që Operatori Ekonomik tërheq kostumet për ti larë është e nevojshme të jetë një kostum rezervë.**

I gjithë materiali i butë duhet të ketë logon dhe emërtimin e MSHMS dhe SUOGJ, datën e futjes në përdorim të stampuar në material jo të dëmshëm për pacientin. Ndërsa materiali i butë i personelit shëndetësor të ketë inicialet e emër, mbiemër dhe emërtimi (mjek, infermier, farmacist dhe profesione të tjera për të bërë dallimin).

- SPECIFIKIMET TEKNIKE:**

SPECIFIKIMET TEKNIKE TË MATERIALIT TË BUTË PËR PACIENTIN					
N R	Emërtimi	Njësia	Specifikimet Teknike	Dimensionet	Lloji i materialit

1	Dyshek	Copë	Dyshek Tek spitalor- Dysheku të jetë ortopedik (me 3 ndarje), përbërja nga brenda me dy shtresa vatine të fortë, ku nga njëra anë të ketë porozitet për qarkullimin e ajrit, dhe i veshur nga jashtë me mbulesë të fortë të padepërtueshme, ignifugo (kundër zjarrit), antibakteriale dhe antialergjike. Mbulesa te jete me zinxhir anësor. Të ketë të shënuar datën e futjes në materialit të butë në përdorim në shërbimin mjekësor. Ngjyra sipas kërkesës se autoritetit kontraktor.	190x90x10 cm- 190x90x25 cm (sipas kërkesave te pavionit)	Veshja e dyshekut me mbulesë (mushama) të padepërtueshme nga uji apo lëngjet biologjike.
2	Çarçaf shtrati i Poshtëm	Copë	160 – 180 gr/m2, Me qepje nga të katërta anët. Ngjyrë e bardhë. Logo MSHMS dhe SUOGJ. Të ketë të stampuar datën e hyrjes së materialit të butë në përdorim në shërbimin mjekësor.	270 x 170 cm	Materiali 75 % Pambuk X 25 % Polyestër . Lahet në temperaturë 60°. Të jetë i hekurosur dhe pa rrudha.
3	Çarçaf shtrati i Sipërm	Copë	160 – 180 gr/m2, Me qepje nga të katërta anët. Ngjyrë e bardhë. Logo MSHMS dhe SUOGJ. Të ketë të stampuar datën e hyrjes së materialit të butë në përdorim në shërbimin mjekësor.	270 x 170 cm	Materiali 75 % Pambuk X 25 % Polyestër . Lahet në temperature 60°. Të jetë i hekurosur dhe pa rrudha.
4	Çarçaf Zarf	Copë	160 – 180 gr/m2 . Dy fletësh, me qepje nga të tre anët, i çarë në fund për të mundësuar futjen e jorganit ne forme zarfi. Ngjyrë e bardhë. Logo MSHMS dhe SUOGJ. Të ketë të stampuar datën e hyrjes së materialit të butë në përdorim në shërbimin mjekësor.	220 x 160 cm	Materiali 75 % Pambuk X 25 % Polyestër . Lahet në temperaturë 60°. Të jetë i hekurosur dhe pa rrudha.
5	Jorgan me vatinë	Copë	Me mbushje me vatinë , me tegela ndarëse në formë kuadrati, veshja e jashtme material pambuku, ngjyrë e bardhë. Logo MSHMS dhe SUOGJ	200 X 140 cm	Mbushje me fibra sintetike
6	Këllëf dysheku (Kundra Ujit)	Copë	Material komplet i gomuar (i papërshkueshëm nga uji) me përmasa 190 x 90 cm qepje me llastik per te futur dyshekun.	190 x 90. Lartesia 10 -25 cm (nga te kater anet)	Materiali i gomuar , I papërshkueshëm nga uji, Lahet në temperaturë te lartë.
7	Jastëk	Copë	Mbushje uniforme me fibra sintetike, ngjyrë e bardhë, me mbulesa dyshe.	50 x 80 cm	Mbushje me fibra sintetike

8	Këllëf Jastëku	Copë	Mbulesë dyshe, ku nga njëra anë ka një të çarë si xhep, për të lejuar futjen e jastëkut. Ngjyrë e bardhë. 160 – 180 gr/m ² . Logo MSHMS dhe SUOGJ. Të ketë të stampuar datën e hyrjes së materialit të butë në përdorim në shërbimin mjekësor.	60 x 90 cm	Materiali 75 % Pambuk X 25 % Polyester . Lahet në temperaturë 60°. Të jetë i hekurosuar dhe pa rrudha.
9	Robdishan salle (Për të sëmurët që operohen)	Copë	Robdishan i hapur në të dy pjesët anësore , me lidhëse ose perçina. Me mëngë të shkurtra. Logo MSHMS dhe SUOGJ. Të ketë të stampuar datën e hyrjes së materialit të butë në përdorim në shërbimin mjekësor.	Gjatesia 150 cm	Materiali 100 % pambuk
10	Këmisha Grashë	Copë	Mbyllja: Me kopsa ose lidhëse në pjesën e përparme ose të pasme (sipas kërkesës së institucionit). Mëngët: Të shkurtra (ose të gjata nëse kërkohet). Prerja: E lirshme për të lejuar lëvizje dhe rehati. Hapje për gjidhënie: Me kapëse ose dizajn i veçantë për akses të lehtë për nënat që ushqejnë.	Përmasa: S, M, L, XL, XXL – të gjitha madhësitë duhet të jenë të disponueshme.	100% pambuk (cotton), cilësi e lartë, hipoalergjik
11	Pelena	Cope	Te jete material 100% pambuk pesha 120 gr/m ²	100 x 100 cm	100% pambuk, pesha 120 gr/m ²
12	Bataniye femijesh	Cope	Ngjyra sipas kërkeses se entit prokurues	Permasa 150x90 cm	Te jete material 60% lesh dhe 40% akrilik,
13	Peceta kirurgjie 75x90 (traversa)	Cope	Te jete material fanellat 75x 90 cm	100% pambuk	Peceta kirurgjie 75x90 (traversa)
14	Garza	Cope	Material pambuku me ngjyrë të bardhë, si dhe datën e futjes në materialit të butë në përdorim në shërbimin mjekësor.	100% pambuk	45 cm x45 cm

Shënim: Marzhi i gabimit do të llogaritet në një mesatar në ± 5 cm.

SPECIFIKIMET TEKNIKE TË MATERIALIT TË BUTË TË PERSONELIT MJEKËSOR

N r.	Emërtimi	Njësia	Specifikimet Teknike	Dimensio net	Lloji I materialit
------	----------	--------	----------------------	--------------	--------------------

1	Përparëse Mjeku (Unisex) Ngjyra e Bardhe	Copë	Me mënge te gjata, me kopsa me percina, me dy xhepa anash, me ngjyre te bardhe, me logo MSHMS dhe SUOGJ. Pjesa e mbrapme me te carë.	S,M,L,X L,XXL	Përzierje 65% pambuk 35% Poliester, Larje ne 60°.
2	Kostume Infermieri (Bluzë me Pantallona Unisex) (Gjate dimrit vishet bluze e bardhe me mënge te gjata poshtë kostumit)	Copë	Bluza me jakë V të trashë me mënge te shkurtra (trecerekshe) dhe dy xhepa anësore poshtë me ngjyrën sipas llojit te shërbimit dhe me logo MSMSH dhe SUOGJ ne te djathte: Infermier Pavioni: Ngjyra bojeqielli e hapur Mjek dhe infermier Blloku Operator: Ngjyra Blu e erret Mjek dhe infermier Reanimacioni: Ngjyra Jeshile e erret Infermier Pediatrie: bluzë me kukulla dhe pantallona ngjyrë bojëqielli, Reanimacion Pediatrie: bluzë me kukulla dhe pantallona ngjyrë lejla e errët. Teknik imazherie: Bluza dhe pantallonat ngjyre gri	(S,M,L,X L,XXL)	Përzierje 65% pambuk 35% Poliester
3	Kostume sanitare (bluzë dhe pantallona unisex) (gjatë dimrit vishet bluzë e bardhë me mëngë të gjata poshtë kostumit)		Bluza me jake V të trashë, me mëngë të shkurtra (trecerekshe) dhe dy xhepa anësore poshtë, me logon MSHMS dhe emërtesën e SUOGJ. Bluza dhe pantallonat me ngjyrën vishnje të errët, sipas modelit.	(S,M,L,X L,XXL)	Përzierje 65% pambuk 35% Poliester
4	Triko Mjeku dhe Infermieri	Copë	Material 100% poliestër 260gr/m². me mengë të gjata. me dy xhepa . Me zinxhir.	(S,M,L,X L,XXL)	Materiali 100% poliestër
5	Pandofla Personeli	Copë	Pandofla për përdorim spitalor, material plastik, me gomë poroze me ngjyra të ndryshme, e mbyllur nga përpara dhe me vrima për ajrosje, e pajisur me një shtresë ortopedike për të lehtësuar qëndrimin për kohë të gjatë në këmbë. Materiali të jetë antirrëshkitës, rezistentë ndaj gërryerjes dhe vajit, si dhe i padepërtueshëm nga uji. Ngjyra sipas kërkesës së autoritetit kontraktor.	Numrat e pandoflav e sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor.	Materiali të jetë plastik, antirrëshkitës, rezistentë ndaj gërryerjes dhe vajit, si dhe i padepërtueshëm nga uji
6	Pandofla Personeli (Për sallat e operacionit)	Copë	Pandofla për përdorim në sallat e operacionit, material plastik, me ngjyra të ndryshme, e mbyllur nga përpara dhe me vrima për ajrosje, e pajisur me një shtresë ortopedike për të lehtësuar qëndrimin për kohë të gjatë në këmbë. Materiali të jetë antirrëshkitës, rezistentë ndaj gërryerjes dhe	Numrat e pandoflav e sipas kërkesës së Autoritetit t	Materiali të jetë plastike, antirrëshkitës, rezistentë ndaj gërryerjes dhe vajit, si dhe i padepërtueshëm

			vajit, si dhe i padepërtueshëm nga uji. Ngjyra sipas kërkesës së AK.	Kontrakt or.	nga uji
7	Peshqirë	Copë	Material pambuku, ngjyrë e bardhë , Logo MSHMS dhe SUOGJ	90 x 60 cm	100% pambuk, lahet në temperaturë 60°.
8	Koordinator me Pacientin	Copë	Pantallona te zeza, T-Shirt POLO me ngjyre gri me tre komça me logon e MSHMS dhe SUOGJ ne te majte. (gjate dimrit vishet xhakete e zeze ose triko e zeze)	(S,M,L,X L,XXL)	

Shënim: Mbasi të jetë lidhur kontrata me OE, gjatë procesit të marrjes në dorëzim të bazës materiale, do të ngrihet një komision i cili duhet të bëjë peshimet e të gjithë zërave të mësipërme për të saktësuar peshën dhe marrë në dorëzim sasinë e materialeve në bazë të specifikimeve teknike. Ky proces duhet të bëhet në prezencën e OE dhe do të firmoset nga të dyja palët. Peshat e bazës materiale do të përdoren në fund të çdo muaji për përlllogaritjen e kilogramëve për faturimin mujor.

- Materialet të jenë të shoqëruara me certifikatë analize dhe logon e SUOGJ-së.
- Materialet ti përgjigjen standardeve STASH në fuqi dhe standardeve europiane CE.
- Kontraktuesi duhet të plotësojë kushtin teknik paraqitjen e mostrave për çdo artikull.

Shënim: OE pavarësisht parashikimeve do të kryejë shërbimin sipas nevojës së diktuar nga shërbimi shëndetësor në S.U.O.GJ. “Mbretëresha Geraldinë”.

Shtojca 9

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet: “Shërbimi i lavanderisë dhe hotelerisë në pavionet e S.U.O.GJ. “Mbretëresha Geraldinë”

Afatet e ekzekutimit:

Shërbimi	Përshkrimi	Shuma totale për 48 muaj	Vendi i ekzekutimit	Afati i ekzekutimit
Shërbim i lavanderisë dhe hotelerisë në pavionet e Spitalit S.U.O.GJ. “Mbretëresha Geraldinë”	Sipas specifikimeve teknike dhe termave të referencës	663,612.68 kg	Në pavionet e Spitalit S.U.O.GJ. “Mbretëresha Geraldinë”	Sipas nevojave të AK, brenda periudhës së vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër

Shtojca 10

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: “Shërbimi i lavanderisë dhe hotelerisë në pavionet e S.U.O.GJ. “Mbretëresha Geraldinë”

Detyrat:

Procedura e grumbullimit të materialeve të ndotura:

- Personeli i OE bën ndarjen e materialeve të ndotura pas çdo ndërrimi të shtratit të pacientit.
- Materialet e kontaminuara lëvizin nga shtrati i pacientit tek karroca e lëvizshme në thesin përkatës.
- Mbledhja e materialeve të kontaminuara bëhet në thasët e vendosur në karrocën e shpërndarjes së teshave pas çdo ndërrimi të shtratit. (Karroca është e lëvizshme. Në pjesën e përparme ka një dollap ku vendosen materialet e pastra. Në pjesën e pasme ose anësore ka dy kosha me thasë të vegjël të mbyllur ku vendosen materialet e kontaminuara).
- Kur thesi është i mbushur në 2/3 e tij, ai transportohet në karrocën e madhe, në vendin e posaçëm (i përcaktuar në pavion) dhe bëhet gati për ti dërguar në lavanderi në orarin e përcaktuar. (Materialet që nga ndarja verifikohen dhe nëse kanë rrezikshmëri, personeli i OE i dërgon në incenerator për t’u djegur nga personeli përgjegjës).
- Karroca e madhe është e vendosur në pavion, në një vend të përcaktuar nga shërbimi e mbuluar dhe me rafte të posaçme në brendësi për vendosjen e thasëve të specifikuar dhe të mbyllur me materialet e kontaminuara.
- Thasët identifikues janë me ngjyrë (sipas kërkesës së AK).
- Karroca e shpërndarjes së materialeve shërben për mbajtjen e materialeve të pastra dhe ka kosha ku vendosen thasët për materialet e kontaminuara.
- Kjo karrocë nuk futet në dhomat e pacientëve por qëndron tek dera e dhomës në korridor.
- Në momentin e ndërrimit të pacientit, duhet të largohet çdo objekt duke bërë kujdes (për çfarë mund të ketë mbi shtrat).
- Materialet e kontaminuara (materialet me sëmundje ngjitëse) vendosen në qese të posaçme dhe dërgohen për tu djegur në incenerator.

Procedura e ruajtjes dhe shpërndarjes së materialeve të pastra:

Operatori Ekonomik që ofron shërbimin e lavanderisë duhet të disponojë të gjitha kapacitetet larëse, tharëse, dezinfektuese, hekurosëse dhe paketuese.

- Të gjitha materialet me të cilat behët ndërrimi i shtratit të pacientit janë të lara, hekurosura dhe të ruhen të paketuara në qese.
- Materialet e pastra mbahen në dollap në dhomën e përcaktuar në çdo pavion.
- Materialet e pastra vendosen në karrocën e shpërndarjes në pavione dhe ndahen sipas një grafiku

ditor të përcaktuar nga K/infermieri i pavionit.

- K/infermieri i pavionit çdo ditë shikon cilësinë e larjes, hekurosjes dhe paketimit të materialeve.
- Të gjitha materialet e shtratit të pacientit janë të ndara dhe të paketuara sipas zërave.
- Materialet e pastra nuk bashkohen me materialet e ndotura.
- Çdo shërbim ka dhomën në dispozicion për depozitimin dhe ruajtjen e materialeve të pastra të cilat gjithmonë duhet të jenë të palosura dhe të paketuara.

1. Kontraktuesi duhet që në materialin e butë që do të sigurohet për nevoja të zbatimit të kësaj kontrate për pacientët dhe sallat operatore (dhe që do të zëvendësohet/ripërtërihet sipas sasisë dhe jetëgjatësisë të përcaktuar më sipër) të stampojë në të: (1) logon dhe emërtimin e autoritetit kontraktor dhe (2) datën e futjes në përdorim të materialit të butë për nevoja të kësaj kontrate, detyrimisht me një material jo të dëmshëm për pacientin dhe që nuk mund të fshihet si pasojë e procesit të larjes, tharjes dhe hekurosjes që zhvillon kontraktuesi.
2. Kontraktuesi detyrohet që të tërheqë dhe dorëzojë materialin e butë në pavionet e autoritetit kontraktor sipas grafikut ditor të hartuar nga kryemamia përkatëse e çdo shërbimi.
3. Përdorimi i inventarit të materialit të butë është nën përgjegjësinë e personelit të kontraktorit i cili kontrollohet nga autoriteti kontraktor sipas procedurave të mëposhtme:
 - 1) Çdo ditë k/infermierja e pavionit ose personi i autorizuar prej saj, përpilon, siglon dhe dorëzon, kërkesën (fletë forcën e pavionit) për ditën e nesërme për material të butë, të cilën e dorëzon brënda orës 12:00 tek sektori i shërbimeve, i autoritetit kontraktor.
 - 2) Sektori i shërbimeve i autoritetit kontraktor, në bazë të kërkesave ditore (fletëve të forcave të pavionit), harton evidencën ditore përmbledhëse në shkallë s.u.o.gj.-je dhe ia dorëzon përfaqësuesit të kontraktuesit brënda orës 13:00 për ditën pasardhëse.
 - 3) Peshimi dhe numërimi i materialit të butë të larë, të thatë, të hekurosur, si dhe të pakeluar do të bëhet çdo ditë në orën 07:00, në ambjentet që do caktohen nga autoriteti kontraktor dhe nën prezencën e përfaqësuesit të autoritetit kontraktor dhe përfaqësuesit të kontraktuesit, duke mbajtur proces-verbalin përkatës të firmosur nga palët. Ky dokument do ketë vlerë financiare, pasi likuidimi i kontraktuesit do të bëhet mbi bazën e proces-verbaleve të nënshkruara çdo ditë nga palët.
 - 4) Vetëm pasi të jetë peshuar dhe numëruar, materiali i butë është gati për tu shpërndarë nga kontraktuesi në shërbimet përkatëse të autoritetit kontraktor, sipas kërkesave të shërbimit të bërë një ditë më parë.
 - 5) Shpërndarja e materialit të butë në pavione, do të bëhet nga kontraktori çdo ditë pas orës 7:00 deri në orën 15:00 (sipas nevojës).
 - 6) Kontraktuesi ia dorëzon materialin e butë kryeinfermieres së pavionit, e cila bën kontrollin për larjen, hekurosjen dhe cilësinë e materialit të butë dhe në rast kostatimi të materialit të butë difektoz ose të papastër, e kthen atë mbrapsht duke pasqyruar faktet e konstatuara në një proces-verbal në të cilin evidentohet saktësisht sasia dhe lloji i materialit të butë të marrë në dorëzim dhe sasia dhe lloji i materialit të butë të kthyer mbrapsht.
 - 7) K/infermierja e pavionit ose personi i autorizuar prej saj, do të evidentojnë në mënyrë të vazhdueshme çdo problem që lidhet me shërbimin e ofruar nga kontraktuesi dhe për çdo parregullsi do të informojë me shkrim sektorin e shërbimeve të autoritetit kontraktor.
 - 8) Tërheqja e materialeve të buta të ndotura nga pavioni, do të bëhet nga kontraktuesi deri në orën 20.00 (sipas nevojës).
 - 9) Shtrimi i shtratit të pacientit në pavion, si për shtrimet e reja ashtu edhe për shtrimet urgjencë, do të jetë nën përgjegjësinë e kontraktuesit.
 - 10) Në të gjitha rastet kur shërbimet kanë nevoja për material të butë shtesë, sektori i shërbimeve të autoritetit kontraktor miraton kërkesën dhe ja përcjell atë kontraktuesit i cili procedon më pas me dorëzimin e materialit të butë shtesë.

- 11) Në raste të konstatimit të dëmtimit të materialit të butë do të mbahet një proces-verbal, të firmosur nga të dyja palët, një kopje e të cilit do të dorëzohet në sektorin e shërbimeve të autoritetit kontraktor dhe kontraktuesi do të bëjë menjëherë zëvendësimet përkatëse.
 - 12) Riparimi i materialit të butë të dëmtuar, bëhet nga kontraktuesi duke ruajtur përmasat, dimensionet, përbërjen dhe të gjitha specifikimet teknike të materialit të butë.
 - 13) Kontraktuesi detyrohet të zëvendësojë materialin e butë të vjetëruar, në përdorim me material të butë të ri sipas jetëgjatësisë së çdo materiali të butë.
 - 14) në të gjitha rastet kur kontraktuesi dhe/ose autoriteti kontraktor konstatojnë material të butë të dëmtuar, të dy palët mbajnë një proces-verbal dhe më pas procedohet me nxjerrjen nga përdorimi të këtij materiali të butë.
 - 15) Materiali i butë duhet të manipulohet me doreza josterile njëpërdorimshe dhe nuk duhet transportuar duke u mbajtur në dorë nga personeli apo duke u lënë në tokë.
 - 16) Kontraktuesi do të bëjë mbledhjen e materialeve të papastra, në një vend të shërbimit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor, në thasët identifikues të cilët do të qëndrojnë aty deri në momentin e dorëzimit.
 - 17) Thasët në të cilët do të vendosen materialet e buta duhet të mbushen deri në 2/3 e tyre, të mbyllen krejtësisht dhe të vendosen në dhomën apo vendin e parashikuar për dorëzimin e materialeve.
 - 18) Thasët nuk duhet të hërhiqen mbi dyshe.
 - 19) Karroca e materialeve shërben për mbajtjen e thasëve me ngjyra, për depozitimin e materialeve të ndotura nga njëri shtrat në tjetrin. Karroca është e pajisur me rrota dhe e ndarë me thasët specifikë me ngjyrë me siglën përkatëse identifikuese.
 - 20) Karroca e materialeve nuk futet në dhomën e pacientit dhe në momentin e ndërrimit të pacientit duhet bërë kujdes për çdo objekt tjetër mbi shtrat.
 - 21) Për raste të gjendjes së jashtëzakonshme, epidemive apo pandemive, lavanderia do të funksionojë sipas kushteve që do të vendosë autoriteti kontraktor.
4. Kontraktuesi detyrohet që të lejojë dhe ti mundësojë autoritetit kontraktor që në prezencë të përfaqësuesit të kontraktuesit të ushtrojë të drejtën e tij të kontrollit, në bazë të programeve të ndryshme të punës së sektorëve të ndryshëm të tij, për të verifikuar ekzistencën ose jo të çdo parregullsie (1) në kryerjen e shërbimeve nga ana e kontraktuesit, (2) në sasinë dhe cilësinë e materialit të butë, në përfundim të të cilave në çdo rast do të mbahet një proces-verbal.
 5. Kontraktuesi detyrohet që të mbulojë të gjitha kostot e ofrimit ndaj autoritetit kontraktor të shërbimit të lavanderisë dhe hotelarisë kundrejt çmimit të kontratës.
 6. Kontraktuesi është përgjegjës për sigurimin e çdo leje apo licëse të nevojshme për kryerjen e shërbimit të tij në zbatim të kontratës.
 7. Personeli i kontraktuesit i cili ngarkohet prej tij në kryerjen e detyrave brenda ambienteve të autoritetit kontraktor është i detyruar që të zbatojë protokollet e kujdesit të higjienës, të kujdesit infermieror, si dhe rregulloret e miratuara apo që zbatohen nga autoriteti kontraktor dhe në rast të shkeljes së tyre kontraktori është i detyruar që ti zëvendësojë këta punonjës në bazë të një kërkesë me shkrim të bërë nga autoriteti kontraktor dhe proces-verbalit që konstaton shkeljen e kryer.
 8. Kontraktuesi detyrohet që të zëvendësojë në çdo rast materialin e butë të dëmtuar apo amortizuar përpara afatit të daljes së tij nga përdorimi.

Shpërndarja: Sipas specifikimeve teknike dhe termave të referencës

Vendi i kryerjes së shërbimeve: Në ambientet e Spitalit Universitar Obstetrik-Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë” Tiranë, sipas specifikimeve teknike

Shtojca 11

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

OFERTUESI DEKLARON SE:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 12.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimi nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 12;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 5;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të përcaktuara në pikën 1, Shtojca 11 të DST.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2022-2023-2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare (2022, 2023, 2024), të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 të Ligjit Nr. 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limitit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë në pronësi, qira ose në përdorim **të paktën 1 (një) ambient, ku shtron veprimtarinë për kryerjen e shërbimit lavanderisë objekt prokurimi.**

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- dokumentacionin që vërteton pronësinë, ose qiramarrjen, ose huapërdorjen (certifikatë pronësie/ kontrata qiraje/ kontrata huapërdorje/ çdo dokument tjetër të vlefshëm, me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).
- akt miratimi higjieno – sanitar për këtë ambient, lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë dhe të paraqesë certifikatë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, dhe të jetë e vlefshme, si më poshtë:

- **SSH EN 14065:2016** mbi “Sistemin e kontrollit të Biokontaminimit”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme.

2.3.4. Operatori ekonomik ofertues, duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë leje mjedisore të Tipit B “Pastrim kimik” (të vlefshme), lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), për vendin ku ushtron këtë aktivitet.

2.3.5. Operatori/ët ekonomik pjesëmarrës për të realizuar shërbimin objekt prokurimi, duhet të ketë minimalisht 26 (njëzet e gjashtë) persona të punësuar, në profilet sipas tabelës si mëposhtme:

Nr	Personeli	Nr.punonjësve
1	Përgjegjës shërbimi	1
2	Punëtorë në lavanderi	7
3	Punonjëse shërbimi ne reparte	18
	TOTALI	26

a) Përgjegjësi i shërbimit, duhet të jetë me profesion kimist/bioteknolog/inxhinier mjedisi duhet të ketë eksperiencë pune të ngjashme të paktën 2 (dy) vite.

Për Përgjegjësin e shërbimit, OE duhet të paraqesë:

- Kontratë individuale pune (e vlefshme), si Përgjegjës shërbimi;
- Diplomë e arsimit të lartë;
- Librezë pune/ deklarata e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale e lëshuar nga e – albania/ cv dhe/ose çdo dokumentacion tjetër që vërteton ekspseriencën e kërkuar.

b) Për punonjësit në pikat 2, 3 në tabelën më sipër, të paraqitet kontratë individuale pune (e vlefshme) përkatëse.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 12 të DT.

Dokumentet provuese të kërkuar më sipër, do të paraqiten nga të gjithë kandidatët e kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

2.3.6 Operatorët ekonomikë ofertues duhet të deklarojnë se punonjësit e deklaruar për këtë procedurë prokurimi: Punonjës shërbimi në Reparte të AK nuk do të jenë të angazhuar në kontrata të tjera gjatë periudhës së vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të deklarojë se disponon, makineritë, dhe pajisjet, si më poshtë:

Nr	Emërtimi	Njësia	Sasia minimale e kërkuar
1	Makineri barriera larëse profesionale min 150 kg	Copë	1 (një) ose me kombinim pajisjesh, për plotësimin e

			sasisë së përcaktuar nga AK
2	Makineri larëse me disa dhoma larjeje min 100 kg	Copë	1 (një) ose me kombinim pajisjesh, për plotësimin e sasisë së përcaktuar nga AK
3	Makineri larëse profesionale min 40 kg	Copë	3 (tre) ose me kombinim pajisjesh, për plotësimin e sasisë së përcaktuar nga AK
4	Makinë tharëse profesionale (me kapacitet mbi 50 kg secila)	Copë	3 tre ose me kombinim pajisjesh, për plotësimin e sasisë së përcaktuar nga AK.
5	Makineri hekurosëse (rul) professional	Copë	2 (dy)
6	Makineri Paketimi Profesionale për paketim rrobash	Copë	1 (një)
7	Karroca të shpërndarjes së materialeve	Copë	12 (dymbëdhjetë)
8	Karroca të mëdha për transportin e materialeve	copë	12 (dymbëdhjetë)
9	Makineri për larjen dhe dizinfektimin e karrocave	Copë	1 (një)
10	Peshore elektronike mbi 100 kg, e cila duhet të jetë e kalibruar dhe të shoqëruar me akt kolaudimi nga autoritete përkatëse (Drejtoria e përgjithshme e Metrologjisë)	Copë	1 (një) ose me kombinim pajisjesh, për plotësimin e sasisë se përcaktuar nga AK

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, duhet të paraqitet:

dokumentacion për pajisjet dhe instrumentet e mësipërme, që vërtetojnë se, këto pajisje dhe instrumente i ka në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 12 të DT.

Dokumentet provuese të kërkuar më sipër, do të paraqiten nga të gjithë kandidatët e kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të disponojë minimumi 1 (një) mjet transporti, me qëllim transportin e materialit të butë, të cilin duhet ta ketë në pronësi, huapërdorje ose me qira.

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, duhet të paraqitet:

- dokumentacion për pajisjet dhe instrumentet e mësipërme, që vërtetojnë se, këto pajisje dhe instrumente i ka në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).
- Leja e qarkullimit të mjetit, policë sigurimi, certifikatë kontrolli teknik, taksa vjetore.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 12 të DT.

Dokumentet provuese të kërkuar më sipër, do të paraqiten nga të gjithë kandidatët e kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

2.3.9 Operatori ekonomik në lidhje me materialin e butë që do të ripërtërihet, duhet të plotësojë tabelën e mëposhtme:

Materialet e Buta				
Nr.	Emërtimi i produktit	Vendi i origjinës	Skede teknike/katalog	Certifikatë konformiteti ose cilësie CE/ ekuivalent akredituar
1	Çarçaf shtrati i poshtem			
2	Çarçaf shtrati i siperm/zarf			
3	Kellef jasteku			
4	Jastek			
5	Kemisha grash			
6	Robdishan pacienti			
7	Tranversa			
8	Peshqire			
9	Garza			
10	Jorgan			
11	Kellef dysheku			
12	Pelena			
13	Batanije femijesh			
14	Pandofla			
15	Kostume te ekipit te salles			
16	Perparese mjeku			

17	Kostume infermieri / personel ndihmes / sanitare (bluza kemisha + pantallona unisex)			
18	Dyshek			
19	Kostume kordinator			

2.3.10.Operatori Ekonomik duhet te dorëzojë dokumentacion teknik mbi produktin larës që do të përdoren për larjen e materialeve të buta “me ndotje spitalore” sipas klasifikimit:

-Material i kontaminuar

-Materiali i kontaminuar, nga një pacient pas ekzaminimit në mjeksinë nukleare

-Material i konsideruar “me rrezik mikrobiologjik”

-Material i “pisët”

Për detergjentet e pastrimit, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- I. Skedat teknike ose katalog të lëshuar nga prodhuesi i produktit, shoqëruar me Certifikatën e Konformiteti ose Cilesia CE për keto lloj produktesh.
- II. Autorizim/Dokument ekuivalent lëshuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi, me anë të cilit vërtetohet se ofertuesi ka siguruar furnizim të rregullt të detergjentëve që do të përdoren për larjen e materialeve të buta “me ndotje spitalore”
- III. Tabelën me produktet dhe emërtimet që do të përdoren si më poshtë vijon:

Materialet e pastrimit				
Nr.	Emërtimi i produktit që do të lahet	Vendi i origjinës së produktit të pastrimit	Lloji/Emërtimi i detergjentit	Certifikatë konformiteti ose cilësie CE/ekuivalent akredituar
1	Material i kontaminuar			
2	Materiali i kontaminuar, nga një pacient pas ekzaminimit në mjeksinë nukleare			
3	Material i konsideruar “me rrezik mikrobiologjik”			
4	Material i pisët			

2.3.11.Operatori ekonomik, duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër kryerjen e shërbimeve, nga punonjës të pajisur me uniformën e punës, me materiale/ pajisje mbrojtëse personale për shëndetin dhe sigurinë teknike në punë.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar nga një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

Shtojca 12

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

PJESA I: A. INFORMACION NË LIDHJE ME OPERATORIN EKONOMIK

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- ---

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Shërbimet/ Mallrat e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

B: DEKLARATA “Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura”

Në cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, **Deklaroj Se:**

Jam në dijeni të pasojave që vinë ndaj meje lidhur me këtë Deklaratë, në respektim të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Kam përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur, pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër⁸.

Në veçanti, pa kufizuar si më lart, nuk kam pasur kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent me qëllim cënimin e konkurrencën, në lidhje me:

- a) çmimet;
- b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
- c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
- d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

⁸ Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që: a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor; b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.

Nuk kam pasur marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent, me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë.

Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura, me qëllim cënimin e konkurrencës, në çdo mënyrë qoftë, konkurrentëve të tjerë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj.

C: DEKLARATA “Mbi Konfliktin e Interesit”

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:

Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

- Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

- Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin,

d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.**

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimi dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA “Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës”

Deklarata
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se:
- Operatori ekonomik _____ garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi. - Operatori ekonomik _____ lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi. - Operatori ekonomik _____ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.
<i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË “Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës”

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të	Po [] Jo []

